



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 42/18
Prishtinë, më 29.01.2019, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Dardan Molliqaj, Mërgim Lushtaku, Enver Hoti dhe Blerim Kuqi.

Munguan: Lumir Abdixhiku, Ali Lajçi, Arbërie Nagavci dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës i ftuar: Fatmir Gashi- Zv.Ministër i Financave, Ismet Krasniqi Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Kosovës, Emrush Haxhiu nga Administrata e Kuvendi., Istret Azemi nga Administrata e Kuvendi.

Pjesëmarrës tjerë: Mërgim Gashi - Monitorues KDI, Violeta Smajlaj- Auditore ZKA, Ariana Rexhëbeqaj - ZKA, Albulena Avdiu- Ekonomia Sot, Albulena Mavraj - Epoka e Re, Majlinda Doda-Radio Kosova,Valdete Berisha - Arbresh.info, Vatra Qehaja - LVV, Shefki Kastrati- NDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Luljeta Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj - Zëvendëskryetare e parë e komisionit (tutje zëvendëskryetarja).

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr.06/L-133 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019;**
- 3. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Vendimin e Qeverisë për ndryshimin e normës së tatimit të akcizës;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2018;**
- 5. Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2018;**
- 6. Miratimi i Planit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2019;**
- 7. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Zëvendëskryetarja: Unë e kam një propozim. Në mbledhjen e fundit ne kemi shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë për zgjatjen buxhetore për muajin shkurt 2019 dhe kemi nxjerrur një rekomandim, për Kuvendin që të autorizojë zgjatjen ndërbuxhetore që të nënshkruhet për vitin 2019 të përcaktuar me ligjin nr.06/L-020, për buxhetin e RKS-së për vitin 2018, mirëpo Kryesia nuk e ka vënë si pikë të rendit të ditës për seancën e nesërme. Propozimi është që në emër të komisionit ti paraqesim Kryetarin të Kuvendit një propozim që kjo pikë të radhitet në rend dite në seancën plenare të datës së nesërm 30.01.2019, si pikë plotësuese.

Bedri Hamza: Ju e keni përkrahur propozim-vendimin e Qeverisë për zgjatjet buxhetore për muajin shkurt 2019, dhe ju falënderoj për kujdesin që keni treguar si komision. Ligjërishtë është e rregulluar që kur ka zgjedhje në pjesën e fundit të vitit atëherë Ligji për financimin e financave publike dhe përgjegjësitë. e lejon që ndarja buxhetore të mund të vazhdojë me automatizëm. Në situatat kur nuk ka zgjedhje në pjesën e fundit të vitit atëherë ligji i njëjtë përcakton që për muajin janar të mund të vazhdoj shpenzimi i buxhetit me automatizëm, ndërsa për dy muajt vijues duhet të ketë autorizim me vendim nga Kuvendi i Kosovës. Pas kësaj periudhe, atëherë ka munësi që të bëhet vetëm pagesa e borxhit të jashtëm dhe asnjë pagesë tjetër. Arsyeja e këtij vendimi është që edhe në situatën që buxheti mundet të kalojë para fillimit të shkurtit, deri sa të hyjë në fuqi e ka kohën e vetë dhe me qëllim që të ketë mundësi të paguajë pagesa për gjërat emergjente të nevojave shtetërore, nevojitet që vendimi të kalojë në Kuvend sepse dihet që buxheti derisa të nënshkruhet dhe deri sa të publikohet në gazetën zyrtare ka procedura. Prandaj unë e vlerësoj shumë lartë kujdesin e juaj që në përputhje me rregulloren aq sa na lejon të i lutim dhe ta këshillojmë Kryesinë e Kuvendit të vendoset si pikë e rendit të ditës dhe mendojë që kishte me qenë mir për seancën e nesërme të jetë pikë e parë e rendit të ditës dhe të votohet.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, zëvendëskryetarja konstatoi se komisionit njëzëri vendosi që të bëjë një propozim për plotësimin e rendit të ditë të Mbledhjes Plenare të datës 30.01.2019, me pikën si vijon:

Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë së Republikës Kosovës nr.03/83, të datës 11 janar 2019, për zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin shkurt të vitit 2019, të përcaktuar me Ligjin nr.06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, të bëhet në Mbledhjen Plenare të datës 30 janar 2019, përmes shmangies nga afatet procedurale, të parapara me nenin 15, paragrafin 7 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Miratimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr.06/L-133 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019

Zëvendëskryetarja: Në raportin me amendamente e kemi dërguar në komisione funksionale në komisionet tjera kryesore. Komisioni për integritet evropiane nuk ka bërë ndonjë vërejtje, ndërsa komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve ka përkrahur disa amendamente të deputetëve që nuk kanë përkrahjen e komisionit dhe njëkohësisht ka propozuar dy amendamente të reja. Ndërkaq, Komisioni për legjislacion nuk ka arritur ta radhisë në rendit dite shqyrtimin e Projektbuxhetit së bashku me amendamentet që kemi propozuar.

Unë do të kisha rekomanduar që ne ta miratojmë raportin me amendamente, ta procedojmë tutje, dhe në ndërkohë besojë që edhe komisioni për legjislacion do ta votojnë dhe do ta kalojnë raportin me amendamente. Ne raportin kur e kemi miratur i kemi thënë stafit që ta analizojë edhe njëherë mos ka ndonjë gabim teknik i cili është bërë pak me shpejtësi rregullimi i amendamenteve dhe stafi e ka vërejtur që janë disa lëshime.

Më pas zëvendëskryetarja lexoi përmirësimet teknike që duhet bërë në amendamentet e caktuara. Zëvendëskryetarja konstatoi se komisioni njëzëri përkrahu dy amendamentet e propozuara nga komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim.

Mërgim Lushtaku: Diskutuam më herët me ministrin për një shqetësim që për mua është shumë i rëndësishëm, dhe ka të bëjë me Ministrinë e Inovacionit, një ministri relativisht e re që ka nevojë për mbështetje, dhe kur është bërë ndryshimi nga amendamentet i është zvogëluar buxheti. Zvogëlimi i buxhetit do të ndikojë në realizimin e plan-programit të saj.

Bedri Hamza: Theksoi se në çdo moment kur organizatat buxhetore arrijnë të i shpenzojnë fondet, ne si Ministri e Financave ose në proces të rishikimit të buxhetit ose në mes rregullimeve të brendshme në përputhje me ligjin ose në tre mujorin fundit të vitit kur ligji e lejon që 5% të ndarjeve buxhetore ka mundësi të ketë rregullime, ne do ti marrim në konsiderat këto.

Mirëpo për këtë fillim vit unë besoj që secila organizatë ka mjete në dispozicion për shpenzim dhe nuk shoh që ne e kemi dëmtuar funksionalitetin e ndonjë organizate buxhetore. Nëse ata kanë progresë të mirë në shpenzimin e buxhetit dhe shohim që kanë munges të fondeve ne do të jemi mbrapa që t'ia kompensojmë.

Zëvendëskryetarja: Me këto sqarime të cilat i dha ministri dhe me përmirësimet teknike që unë i lexova dhe përkrahejn e dy amendamenteve të përkrahur të komisionit për komunitete, propozoj që të votojmë raportin me amendamente dhe të procedojmë tutje.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Zëvendëskryetarja konstatoi se Komisioni me 5 vota Për, 1 Kundër dhe 1 Abstenim, nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me amendamente për Projektligjin nr.06/L-133 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra dhe i njëjti procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Vendimin e Qeverisë për ndryshimin e normës së tatimit të akcizës

Zëvendëskryetarja: Në bazë të nenit 3 të Ligjit nr.03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-112 për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, Qeveria e Republikës së Kosovës (tutje Qeveria) në konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës, mund të ndryshojë normën e tatimit të akcizës apo mund të shtojë listën e mallrave në Aneksin A të këtij ligji, që do ti nënshtrohen normës së tatimit të akcizës. Qeveria ka marrë një Vendim më dt. 09.10.2018 të cilin e ka proceduar në Komision për konsultim, për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit të Qeverisë nr.11/64, të datës 16.12.2015, dhe si rrjedhojë këtij vendimi ti shtohet një pike e re 1A, me tekstin si në vijim: 1.A. Norma e akcizës për cigaret e prodhura në Republikën e Kosovës (Kodin tarifor 2402 2010 11 dhe 2402 2090 11) përllogaritet duke përdorur metodën sipas vlerës (ad valorem) dhe përllogaritja bëhet në çmimin e shitjes me pakicë me normë 30% për qind në vlerën shitëse me pakicë. Qeveria, vendimit të saj i ka bashkangjitur Kocept Dokumentin për ndryshimin e Politikave Fiskale dhe Bujqësore për prodhimin e Dhanit dhe Cigarave në Kosovë.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur me datë 26.10.2018, ka shqyrtuar dhe nuk ka përkrahur Vendimin e Qeverisë. Qeveria me datë 26.12.2018, ka ri-proceduar Vendimin e njëjtë për konsultim në Komision.

Komisioni për buxhet dhe financa nuk e ka përkrahur këtë vendim për shkak se nuk është paraparë një formë e tillë e ndryshimit të akcizës në marrëveshjen e stabilizim asociimit. Ne këtu kemi pasur një

shkresë nga Zyra e BE-së të nënshkruar nga znj. Apostolova e cila ka kërkuar nga Komisioni që një vendim i tillë i Qeverisë të mos përkrahet. Ne e kemi kthyer prapa vendimin e Qeverisë që të harmonizohet me Zyrën e BE-së. I ftuar është zv.ministri i financave, për të dhënë arsyetimet e nevojshme.

Fatmir Gashi: Qeveria me kërkesë të Odës Ekonomike e ka formuar grupin punues për formimin e koncept dokumentit në lidhje me industrinë e duhanit. Qëllimi i koncept-dokumentit i ka dy rekomandime. Ne kemi kërkuar ndryshime edhe politike bujqësore edhe kemi kërkuar ndryshimin e politikës fiskale. Këtë e bazojmë edhe në Direktivën Evropiane 2011/04 që është në fuqi. Në bazë të kësaj Direktive dy krahu të Portugalisë iu lejohet ta lirojnë akcizën deri në 50% për arsye se ajo krahinë janë të varura në ekzistencë për duhan, njëjtë është e zhvilluar edhe në Francë në pozitë 50% e akcizës së duhanit.

Ne po tentojmë si Qeveri me ngritë një industri e cila është zhdukur pas luftës, pra ta kthejë kulturën e duhanit dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Zhvillimit Rural janë urdhëruar që të nxjerrë rregullore apo të bëjnë ndryshim në rregullore për subvencionime ku të futen edhe duhani në subvencionim njëjtë sikurse e ka edhe Maqedonia.

Ne prej fillimit në Bashkimin Evropian e kërkojmë atë sepse direktivat, shteteve të njejtë në Evropë po ju lejojnë benefite ndërsa neve nuk na e lejojnë këtë benefit. E gjitha kjo nuk është qëllim me qenë kundër MSA-së, kundër Evropës qëllimi është me zhvillu një industri e cila është në zhdukje. Qëllimi kryesor nuk ka qenë me zvogëlu akcizën për duhanin, por qëllimi ka qenë me ngritë industrinë të cilën e kemi zhduk ky është shpejgimi dhe arsyeja.

Naser Osmani: Pyeti a ka cigare që prodhohen në Kosovë?

Fatmir Gashi: Momentalisht nuk ka asnjë.

Naser Osmani: Atëherë ku qëndron problemi, kur nuk kemi fare eksport, baza është zero sepse bëhet fjalë vetëm për prodhimet e Republikës së Kosovës të cilën nuk e ka.

Enver Hoti: Unë ju bëj thirrje të gjithëve që ta përkrahni këtë vendim dhe këtu kemi edhe një letër me të gjitha ndryshimet të cilat janë bërë si edhe për MSA-në, mendoj që duhet ti japin një mundësi zhvillimit të kësaj industrie e cila do të ishte në mision të rritjes në punë dhe ti ndryshojë ndonjëherë raportet tregtare, e di që lëvizjet e tregtarëve mund të jenë më të forta. Ne si komision duhet ti marrim parasysh interesat e vendit dhe kultivimit ti japim rëndësi dhe ju bëj thirrje që ta mbështesim.

Naser Osmani: Nuk mund të bëhet akciza e duhanit dhe lënda e parë vetëm të deponohet, në momentin kur duhani nuk futet në depo i nënshtrohet akcizës. Në mandatin e kaluar është bërë një grup punues i cili ka punuar shumë por edhe ka ndihmuar edhe institucione profesionale, por nuk kemi arritur ta procedojmë për shkak të pushimit të Qeverisë. Fabrika e cigareve që ka qenë në Gjilan ka pasur të punësuar një numër të madh zingjir të të punësuarish. Tani nuk po e kuptoj mirë përlllogaritjen në vlera dhe në sasi, ku është ndryshimi buxhetit dhe pyetja ime është se a ka? Sepse nuk mundesh me vënë akcizë në një lëndë që nuk ka, sepse nuk bëhet fjalë për duhanin në tërësi por bëhet fjalë për duhanin e prodhuar në Kosovë. Më tepër më intereson pjesa e strategjisë dhe e dokumentit.

Zëvendëskryetarja: Thekosi se mos vallë ky vendim bjenç në kundërshtim me kodin e doganave dhe të akcizës dhe ne po bëjmë ndonjë shkelje ligjore. Mos ka qenë më mirë me ndryshu fillimisht kodin e akcizës dhe doganës e pastaj ne të procedojmë me këtë vendim?

Fatmir Gashi: Zonja kryesuese ju përmendet nenin e ligjit, i cili parashe mundësinë që Qeveria në konsultim me Komisionit për Buxhet dhe Financa të mund të ndryshojë normën e akcizës, në aneksin A të ligjit dhe këtu nuk kemi të bëjmë me asnjë lloj shkelje ligjore.

Zëvendëskryetarja: Me sa e di unë në Ligjin për kodin e Doganave dhe akcizës ndërrohet sistemi i pagesës në vlerë, kurse këtu po ndërrohet edhe sistemi i pagesave në vlerë dhe sasi. Po biem në kundërshtim me Ligjin për doganat.

Naser Osmani: Kjo nuk ka të bëjë me Dogana, sepse kjo lëndë prodhohet këtu nuk importohet. Dogana e bën llogaritjen në bazë të vlerës së mallit 1000 copë.

Fatmir Gashi: Unë jam konsultuar me zyren ligjore dhe ky propozim nuk është në kundërshtim me ligjin.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Zëvendëskryetarja konstatoi se Komisioni me 5 vota Për, 1 Abstenim dhe asnjë Kundër, nxori këtë

Përfundim

Komisioni për Buxhet dhe Financa, përkrahu Propozim-Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.11/68, datë 09.10.2018 (i ri-proceduar me Vendimin e Qeverisë nr.16/81, datë 24.12.2018) për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit e Qeverisë nr.11/64, të datës 16.12.2015, që pas pikës 1 të Vendimit Nr. 11/64, të datës 16.12.2015, të shtohet një pikë e re me numrin rendor 1A, me tekstin si në vijim: *“1.A. Norma e akcizës për cigaret e prodhura në Republikën e Kosovës (Kodin tarifor 2402 2010 11 dhe 2402 2090 11) përlllogaritjet duke përdorur metodën sipas vlerës (ad valorem) dhe përlllogaritja bëhet në çmimin e shitjes me pakicë me normë tridhjetë (30%) për qind në vlerën shitëse me pakicë.”*

4. Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2018

Zëvendëskryetarja: Raportin e punës së Komisionit e keni pasur edhe në mënyrë elektronike dhe në kutitë e postës, por shpresoj që i keni rishikuar. Nëse nuk keni diçka propozojë miratimin e tij.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Zëvendëskryetarja konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

Përfundim

Komisioni miratoi Raportin vjetor të punës së Komisionit për vitin 2018.

5. Miratimi i Planit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2019

Zëvendëskryetarja: Janë përfshirë të gjitha aktivitetet në bazë të asaj çka është me rregullore të punës dhe me ligj. Vitin e kaluar përveç monitorimit të një ligji, në pjesën e dytë kemi filluar dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për fondet pensionale dhe meqë puna nuk është përfunduar është paraparë që të bëhet në pjesën e parë të këtij viti. Për pjesën e dytë propozojë që të bëjmë monitorimin e Ligjit për Sigurimet.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Zëvendëskryetarja konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

Përfundim

Komisioni miratoi Planin vjetor të punës së Komisionit për vitin 2019, me një plotësimi: shtohit mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Sigurimet në pjesën e dytë të vitit.

6. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2018

Isment Kransiqi: Theksoi se për paga dhe mëditje kanë qenë të shpenzuara 69.82%, mallrat dhe shërbimet 41.38%, shpenzimet komunale 57.66%, subvencione dhe transfere 71.60%, shpenzimet kapitale kanë qenë shumë minimale 1.56% dhe këto kanë qenë të dhënat për 3 mujorin e tretë të vitit 2018. Ndërkaq, për shkak të kontratave që kanë qenë në zbatim e sipër, në fund të vitit gjendaj e shpenzimeve është më e lartë, për çfarë edhe do të përgaditet dhe prezantohet raporti vjetor.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Zëvendëskryetarja konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

Të miratohet Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2018.

7. Të ndryshme

Naser Osmani: Propozojë që Komisioni ti drejtohet me një kërkesë GIZ-it që të financojë një ekspert që ti ndihmojë Grupit Punues të caktuar për shqyrtimin e Projektligjit për TVSH-në. Propozojë që si ekspert të propozohet të jetë Ruzhdi Zenelaj.

Zëvendëskryetarja: Konstatoi se Komisioni unanimisht, vendosi që ti drejtojë një GIZ-i për angazhimin dhe financimin e ekspertit të jashtëm, z.Ruzhdi Zenelaj, për të bërë analizë dhe ndihmuar Grupin Punues të Komisionit gjatë procesit të shqyrtimit dhe amendamentimi të Projektligjit për TVSH-në.

Mbledhja përfundoi në orën 15:05.

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Zëvendëskryetarja e parë e komisionit,

Safete Hadergjonaj